



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 17 tetor 2017

Numri i lëndës: 2016-36

Namon Statovci

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 17 tetor 2017, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar
Znj. Elka ERMENKOVA, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi me 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar në Panel me datën 20 dhjetor 2016.

II. FAKTET

2. Faktet e lëndës të paraqitura nga ankuesi mund të përmbliidhen si më poshtë:
3. Ankuesi ishte azilkërkues në Suedi gjatë një periudhe të caktuar kohore. Ai ishte kthyer vullnetarisht në Kosovë me 7 prill 2010. Atij iu ishte premtuar ndihmë pas kthimit të tij nga palë të pa cekura.

4. Me 7 korrik 2010, ankuesi ka parashtruar kërkesa tek zëvendësministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, me qëllim që ndër të tjera të marrë ndihmë financiare dhe ndihmë për strehimin e tij dhe të familjes së tij. Në të njëjtën datë, ankuesi ka parashtruar kërkesa pranë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale duke kërkuar të njëjtën ndihmë.
5. Me 27 korrik 2010, ankuesi po ashtu ka bërë një kërkesë në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, ku ka kërkuar material ndërtimor.
6. Ankuesi pohon se ai asnjëherë nuk ka marrë përgjigje ndaj kërkesave të tij.
7. Ai ka thënë se Ministria e Brendshme, Departamenti për Riatdhesim, ka kërkuar nga ai disa dokumente shtesë, të cilat i kishte ofruar.
8. Me 20 shtator 2012, kryetari i Komunës së Ferizajt i ka shkruar Këshillit Ekzekutiv të Departamentit për Riatdhesim të Ministrisë së Brendshme, duke rekomanduar që kërkesa e parashtruesit të ankesës për material ndërtimor të miratohej.
9. Me 24 dhjetor 2013, Ministria e Punëve të Brendshme, Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, ka hedhur poshtë kërkesën e ankuesit.
10. Me 7 shtator 2016, Gjykata Themelore e Prishtinës, Departamenti i Çështjeve Administrative, ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e ankuesit për prishjen e vendimit të datës 24 dhjetor 2013.
11. Me 3 nëntor 2016, ankuesi është ankuar ndaj aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës.
12. Me 12 janar 2017, Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti Administrativ, ka refuzuar ankesën e tij si të pabazuar.

III. ANKESË

13. Ankuesi thekson se rregullat e riatdhesimit dhe riintegrimit nuk janë zbatuar dhe prandaj të drejtat e tij janë shkelur. Ankuesi nuk i referohet ndonjë të drejte të saktësuar të njeriut apo ndonjë dispozite të të drejtave të njeriut që është shkelur.

IV. LIGJI

14. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar që të zbatoj instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat

Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.

15. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendosë nëse do të vazhdojë me ankesat, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së punës.
16. Sipas Rregullës 25, paragrafi 1, Paneli mund të shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në gjyqësi, polici dhe dogana.
17. Paneli thekson që ankesa e ankuesit duket se ka të bëjë ekskluzivisht me procedurat administrative pranë zyrave publike dhe gjykatave në Kosovë, rreth të cilave Paneli nuk ka kompetencë (shih p.sh. *Z.A. kundër EULEX-it*, 2014-36, 29 shkurt 2016, paragrafi 17 dhe referencat e cituara). Për më tepër, nuk është argumentuar, e lëre më treguar se EULEX-i ishte përfshirë në çfarëdo cilësie në këto çështje. E as nuk është treguar në ndonjë mënyrë se si EULEX-i mund t'i kishte shkelur të drejtat e ankuesit.
18. Rrjedhimisht, kjo ankesë bie jashtë fushëveprimit të mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë dhe si rrjedhojë jashtë kompetencës së Panelit, siç është saktësuar në rregullën 25 të rregullores së punës (shih *Qerim Begolli kundër EULEX-it*, 2014- 27, 2 shkurt 2015, paragrafi 12, *Mensur Fezaj kundër EULEX-it*, nr. 2014-20, 26 gusht 2014, paragrafët 9-10).

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, pasi ajo bie jashtë kompetencave të tij në bazë të nenit 29(d) të rregullores së vet të punës dhe prandaj

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese